



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 par. 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/ L-087, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31 e datës 15 qershor 2008, Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Ligjit nr. 05/l -009 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar më Ligjin nr. 04/l-111 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2026 të miratojë këtë :

PROPOZIM

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE NË NDËRMARRJEN
PUBLIKE LOKALE "PASTRIMI"

Neni 1

Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Pastrimi"
(në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon :

1. Sead Aliu, anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës
2. _____, anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe ,
3. _____, anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 2

Komisioni do të veprojë në emër të Komunës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Komisioni i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të Ligjit për Ndërmarrjet publike. Komisioni do t'i sigurojë të dhëna

kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes publike lokale në interes të Komunës.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit komunal të aksionarëve 15-463/ 06-21274 i datës 26.04.2022 .

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza juridike për të miratuar këtë Propozim - Vendim është e përcaktuar me dispozitat e neneve nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 5 par. 5.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/ L-087, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.31 e datës 15 qershor 2008, Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Ligjit nr. 05/l -009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-087 për ndërmarrjet publike i ndryshuar dhe i plotësuar më Ligjin nr. 04/l-111 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-12971
Lipjan, Më 18.03.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

